



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim Konsekutiv (A-B/B - A)1

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë, 15 leksione, 25 seminare.

Viti / Semestri: Viti III , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: T'u japë studentëve njohuri të plota mbi procesin e zbërthimit të teksteve si bazë për përkthimin me gojë. Të zhvillojë kompetencën gjuhësore të studentëve për të interpretuar saktë në kontekste të ndryshme gjuhësore dhe kulturore. Të forcojë integrimin e njohurive ndërdisiplinore nga fusha si stilistika, leksikologjia dhe gramatika në funksion të përkthimit me gojë.

Objektivat specifike lëndore :

1. T'i pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të identifikuar dhe trajtuar anshmërinë, keqinformimin, kontekstin e audiencës dhe nuancat kulturore në tekst.
2. Të trajtojë në mënyrë teorike dhe praktike dukuritë gramatikore, leksikore dhe stilistike në varësi të stilit funksional të teksteve.
3. T'i njohë studentët me teknikat dhe procedurat bazë të interpretimit konsekutiv dhe t'i nxisë t'i zbatojnë ato në situata konkrete komunikimi.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë të aftë të analizojnë në mënyrë të thelluar tekste të ndryshme për qëllime interpretimi me gojë.
2. Do të aplikojnë teknikat e interpretimit konsekutiv në mënyrë të saktë, duke marrë parasysh kontekstin gjuhësor, kulturor dhe informativ.
3. Do të tregojnë kompetencë të zgjeruar në ndërthurjen e njohurive nga fusha të ndryshme gjuhësore për të përmirësuar cilësinë e interpretimit